



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MEMALIAJ  
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 2999 .prot.

Memaliaj, më 17.12. 2025

**VENDIM**

**NR.15, DATË 17.12.2025**

**“Për vijimin e procedurave të shqyrtimit të paketës fiskale, buxhetit të vitit 2026 dhe PBA 2026–2028 dhe përmiratimin e rendit të ditës për mbledhjen jashtë radhe”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 27.02.2020 e ndryshuar, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës **03.12.2025**:

**VENDOSI:**

1. Pavarësisht faktit se dokumentacioni për paketën fiskale, buxhetin e vitit 2026 dhe PBA 2026–2028 është paraqitur me vonesë dhe jashtë afateve ligjore, çka ka kufizuar hapësirën dhe mundësinë për zhvillimin e një procesi të plotë njoftimi dhe konsultimi publik, bazuar në Ligjin nr. 146/2014” Për njoftimi dhe konsultimi publik” dhe Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 18, Kryesia e Këshillit Bashkiak vendos të angazhohet maksimalisht në vijimin e procedurave, me qëllim që komuniteti të mos dëmtohet nga kjo situatë, duke shpresuar që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.
2. Të caktojë datën 24.12.2025, ora 11:00, për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak për shqyrtimin e paketës fiskale dhe projektbuxhetit të Bashkisë për vitin 2026, si dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028.
3. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak, sipas projekt vendimeve nr. 2990/1 prot , datë 16.12.2026 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 Bashkia memaliaj” dhe projekt vendimeve nr 2950/2/1prot , datë 12.12.2026 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 të Bashkia Memaliaj”.

4. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes.
5. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

**Flamur Mushamati**



Anëtar i Kryesisë së Këshillit

**Asqeri Muçoima**

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

**Petrit Lumani**



Anëtar i Kryesisë së Këshillit

**Arsola Muzha**

